



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE E RREGULLORËS: 16.09.2021			
DATE E PUBLIKIMIT: 16.09.2021			
DATE E SHPALLJES: 16.09.2021			
DATE E SHPALLJES: 16.09.2021			
Indeksi Org. Org. Jedin. Org. Unit.	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fajevë Br. Stranica No. Pages
01	10	1837	20



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/10 qershor 2016);

Auditori i Përgjithshëm, miraton:

**RREGULLORE (ZKA) Nr. 02/2021**  
**PËR KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS**  
**NË ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT**

Prishtinë, 16 shtator 2021

## KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohet klasifikimi i vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ZKA).
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për personelin e ZKA-së.

### Neni 2 Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termet dhe shprehjet në vijim, kurdo që përdoren, kanë kuptimin e përcaktuar si më poshtë:
  - 1.1. “**Ligj**” - Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.
  - 1.2. “**Legjislacion**” - aktet juridike që aplikohen në Republikën e Kosovës.
  - 1.3. “**Auditim**” - “auditim financiar dhe i pajtueshmërisë”, “auditim i pajtueshmërisë”, dhe “auditim i performancës dhe TI” kanë kuptimin e njëjtë sikurse është përcaktuar në SNISA.
  - 1.4. “**Auditor**” nënkupton zyrtarin e autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm, për t’i kryer funksionet e parapara me Ligj.
  - 1.5. “**ONISA**” (ang:INTOSAI) nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
  - 1.6. “**SNISA**” nënkupton Parimet dhe Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, të nxjerra nga ONISA.
  - 1.7. “**ZKA**” nënkupton Zyrën Kombëtare të Auditimit.
  - 1.8. “**Personel**” apo “**nëpunës**” nënkupton të punësuarit në ZKA.
  - 1.9. “**Vendi i punës**” ose “**pozita e punës**” - kanë kuptimin e njëjtë, por përdorimi i njërit ose tjetrit fjalë përdoret përshtatshëm me kontekstin e fjalisë.

### Neni 3 Kriteret për klasifikimin e vendeve të punës

1. Kriteret për klasifikimin e vendeve të punës janë:

- 1.1. **Përgjegjësia** - përcakton nivelin e përgjegjësisë së vendit të punës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ZKA, vendimmarrje, menaxhim të personelit dhe burimeve tjera;
  - 1.2. **Kompleksiteti** - përcakton nivelin e ndërlikueshmërisë dhe llojllojshmërisë së detyrave të punës;
  - 1.3. **Kualifikimet** - përcaktojnë nivelin e arsimimit, trajnimeve dhe njohurive përkatëse për ushtrimin e detyrave të vendit të punës;
  - 1.4. **Përvoja profesionale** - përcakton detyrat, natyrën dhe cilësinë e përvojës së punës, të ndërlidhur drejtpërdrejtë me profesionin e nëpunësit;
  - 1.5. **Përvoja menaxheriale** – nënkupton menaxhimin e proceseve audituese dhe jo-audituese duke përfshirë edhe udhëheqësin e ekipit të auditimit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin titull të vendit të punës përcaktohen me aktin për përshkrimin e vendit të punës.

#### **Neni 4** **Kategoritë e klasifikimit të vendeve të punës**

1. Vendet e punës në ZKA klasifikohen në këto kategori funksionale:
  - 1.1. **Kategori e lartë drejtuese** - përfshinë vendet e punës të përcaktuara me neni 9.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit;
  - 1.2. **Kategori e mesme drejtuese** - përfshinë drejtorët e departamenteve dhe njësite të veçanta organizative;
  - 1.3. **Kategori e ulët drejtuese** - përfshinë vendet e punës “udhëheqës i divizionit”;
  - 1.4. **Kategori profesionale** - përfshinë kategorinë që zbaton detyra profesionale dhe që nuk ka përgjegjësi mbikëqyrëse;
  - 1.5. **Kategori mbështetëse** - përfshinë kategorinë e personelit që kryen mbështetje teknike për nevoja të ZKA-së.

## **KAPITULLI II** **KATEGORIA E LARTË DREJTUESE**

### **Neni 5** **Zëvendës Auditor i Përgjithshëm**

1. Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm ushtron të gjitha funksionet dhe kryen të gjitha detyrat dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune janë:

- 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tetë (8) vite përvojë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës publike;
  - 2.3. Pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Preferohet të jetë i certifikuar për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A1.

**Neni 6**  
**Ndihmës Auditor i Përgjithshëm**

1. Ndihmës Auditor i Përgjithshëm, është përgjegjës për menaxhimin e departamenteve përkatëse të auditimit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike ose administratës publike;
  - 2.3. Pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Të jetë i certifikuar për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A2.

**Neni 7**  
**Drejtor i Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për tërë mbështetjen administrative.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në ekonomi, drejtësi ose administratë publike;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës publike;
  - 2.3. Katër (4) vite përvojë menaxheriale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C1.

## **KAPITULLI III KATEGORIA E MESME DREJTUESE**

### **Neni 8**

#### **Drejtore i Departamentit të Auditimit**

1. Drejtore i departamentit të auditimit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e ekipeve të auditimit ose mbikëqyrjen e funksioneve përkatëse në menaxhimin e cilësisë në auditim.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, të metodologjisë, të sigurimit të cilësisë në auditim si dhe për planifikim strategjik dhe analiza janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës dhe të prokurimit, janë:
  - 3.1. Diplomë fakulteti;
  - 3.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
  - 3.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 3.4. Certifikatë për auditim të jashtëm (certifikim për auditor ose auditor i certifikuar i sektorit publik);
  - 3.5. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
4. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e sistemeve të TI-së, janë:
  - 4.1. Diplomë fakulteti;
  - 4.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e TI-së;
  - 4.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 4.4. Preferohet certifikimi për auditor nga fusha e TI-së;
  - 4.5. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A3.

### **Neni 9**

#### **Drejtore i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve**

1. Drejtore i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:

- 2.1. Diplomë fakulteti në shkenca juridike;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Preferohet Provimi i Jurisprudencës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B2.

#### **Neni 10**

##### **Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar**

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Njohuri e gjuhës angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B2.

#### **Neni 11**

##### **Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore**

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C2.

#### **Neni 12**

##### **Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përbashkëta**

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;

- 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
- 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C2.

**Neni 13**  
**Drejtor i Departamentit për Teknologji të Informacionit**

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në fushën përkatëse të teknologjisë së informacionit;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C2.

**Neni 14**  
**Udhëheqës i Njesisë së Prokurimit**

1. Udhëheqësi i kësaj njësie ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhim të efektshëm të njësisë.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C3.

**Neni 15**  
**Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

1. Drejtori i kësaj njësie zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhim të efektshëm të njësisë.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
  - 2.4. Të jetë i certifikuar për auditim të brendshëm sipas legjislacionit në fuqi.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B1.

**KAPITULLI IV**  
**KATEGORIA E ULËT DREJTUESE**

**Neni 16**  
**Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore**

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

**Neni 17**  
**Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa**

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

**Neni 18**  
**Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë**

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

**Neni 19**  
**Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përkthimit**

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.



2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
  - 2.3. Njohje e gjuhës serbe ose angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

#### **Neni 20**

##### **Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Dokumentacionit**

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

#### **KAPITULLI V**

##### **KATEGORIA PROFESIONALE**

#### **Neni 21**

##### **Auditor specialist për metodologji**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku pesë (5) vite në ZKA;
  - 2.3. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në udhëheqjen e ekipeve të auditimeve në ZKA;
  - 2.4. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Për kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës dhe auditimet e teknologjisë informative kërkohen kualifikimet e përshkuara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 25 të kësaj Rregulloreje.
4. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A4.

**Neni 22**  
**Auditor specialist për sigurimin e cilësisë**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet financiare dhe pajtueshmërisë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku pesë (5) vite në ZKA;
  - 2.3. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në udhëheqjen e ekipeve të auditimeve në ZKA;
  - 2.4. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Për kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës dhe auditimet e teknologjisë informative kërkohen kualifikimet e përshkruara në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 25 të kësaj Rregulloreje.
4. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A4.

**Neni 23**  
**Auditor specialist për planifikim strategjik dhe analiza**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku pesë (5) vite në ZKA;
  - 2.3. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A4.

**Neni 24**  
**Specialist për teknologji të informacionit**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti, preferohet në shkencat kompjuterike;
  - 2.2. Përvojë pune profesionale prej shtatë (7) vitesh në menaxhim, zhvillim, analizë, integrim ose zbatim të sistemeve softuerike;
  - 2.3. Njohuri të gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A5.

**Neni 25**  
**Auditor Senior**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik);
  - 2.3. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3) vite në ZKA;
  - 2.4. Të ketë përvojë pune në udhëheqjen e tre (3) auditimeve në ZKA.
3. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës janë:
  - 3.1. Diplomë fakulteti;
  - 3.2. Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik) apo të ketë diplomë master;
  - 3.3. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku tre (3) vite në auditim të performancës;
  - 3.4. Të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve në ZKA;
  - 3.5. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
4. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e teknologjisë së informacionit janë:
  - 4.1. Diplomë fakulteti në fushat relevante të TI-së;
  - 4.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e auditimit;
  - 4.3. Të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve në ZKA;
  - 4.4. Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
  - 4.5. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A6.

**Neni 26**  
**Auditor**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje të kufizuar dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist i certifikuar ose auditor i sektorit publik);

2.3 Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike, prej tyre, së paku tre (3) vite në auditim të jashtëm.

3. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës janë:

- 3.1. Diplomë fakulteti;
- 3.2. Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist i certifikuar ose auditor i sektorit publik) apo diplomë në master;
- 3.3. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku dy (2) vite në auditimin e performancës;
- 3.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

4. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e teknologjisë së informacionit janë:

- 4.1. Diplomë fakulteti në fushat relevante të TI-së;
- 4.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;
- 4.3. Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
- 4.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A7.

### **Neni 27** **Auditor junior**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.

2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë janë:

- 2.1. Diplomë fakulteti;
- 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- 2.3. Certifikatë në njërën nga skemat e certifikimit si teknik kontabilitetit dhe asistent-auditor i sektorit publik.

3. Kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës janë:

- 3.1. Diplomë fakulteti;
- 3.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale në hulumtim apo analiza, preferohet përvojë në auditim;
- 3.3. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

4. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A8.

**Neni 28**  
**Zyrtar i lartë kundër mashtrimeve**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në shkenca juridike ose ekonomike;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës hulumtuese dhe analitike;
  - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës ose certifikim kundër mashtrimeve.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B3.

**Neni 29**  
**Zyrtar i lartë ligjor**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në shkenca juridike;
  - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës hulumtuese dhe analitike;
  - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B4.

**Neni 30**  
**Zyrtar ligjor**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në shkenca juridike;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

**Neni 31**  
**Zyrtar për Bashkëpunim**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikëqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:

- 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën komunikimit;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B4.

**Neni 32**  
**Zyrtar për Komunikim me Media**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në fushën e gazetarisë ose komunikimit masiv;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
  - 2.3. Preferohet njohuri të gjuhës angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B5.

**Neni 33**  
**Zyrtar për Dizajnim të Raporteve dhe Publikime**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik ose të ngjajshme;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
  - 2.3. Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

**Neni 34**  
**Zyrtar për Zhvillim Profesional**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në komunikim, organizim, planifikim etj.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C6.

**Neni 35**  
**Zyrtar për Burime Njerëzore**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Dy (2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në komunikim, organizim, planifikim etj.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C7.

**Neni 36**  
**Zyrtar për Buxhet dhe Financa**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Dy (2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në planifikim dhe analiza.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C7.

**Neni 37**  
**Zyrtar Certifikues**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

**Neni 38**  
**Zyrtar për Logjistikë**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C8.

**Neni 39**  
**Përkthyes**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C6.

**Neni 40**  
**Zyrtar për Administrim të Rrjetit dhe Sistemeve të TI-së**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
  - 2.3. Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informacionit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C4.

**Neni 41**  
**Zyrtar për softuer dhe harduer**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
  - 2.3. Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informacionit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C4.

**Neni 42**  
**Zyrtar për përkrahje të sistemeve**

1. Ky vend pune zbaton detyrat profesionale, pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe me udhëzime të herëpashershme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:



- 2.1. Diplomë fakulteti;
  - 2.2. Dy (2) vite përvojë pune profesionale;
  - 2.3. Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informacionit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C4.

## **KAPITULLI VI KATEGORIA MBËSHTETËSE**

### **Neni 43 Zyrtar për administrim të dokumenteve**

1. Ky vend pune zbaton detyrat teknike administrative me mbikëqyrje të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Shkollë e mesme;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C8.

### **Neni 44 Vozitës**

1. Ky vend pune zbaton detyrat teknike administrative me mbikëqyrje të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Shkollë e mesme;
  - 2.2. Tre (3) vite përvojë pune;
  - 2.3. Patent shofer (kategoria B).
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C9.

### **Neni 45 Mirëmbajtës i objektit dhe shërbimeve postare**

1. Ky vend pune zbaton detyrat teknike administrative me mbikëqyrje të vazhdueshme nga mbikqyrësi.
2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:
  - 2.1. Shkollë e mesme;
  - 2.2. Dy (2) vite përvojë pune.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C9.

## **KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 46**

#### **Emërtimi i vendeve të punës, pagat dhe përshkrimi i detyrave**

1. Personelit sipas klasifikimit paraprak të vendeve të punës, iu zëvendësohen, plotësohen dhe/ose harmonizohen aktet individuale të marrëdhënies së punës, në përputhje me ndryshimet sipas kësaj Rregulloreje.
2. Lartësia e pagave dhe shtesave në pagë përcaktohet me vendim të Auditorit të Përgjithshëm sipas ndarjes buxhetore nga Kuvendi i Kosovës.
3. Përgatitja e përshkrimit të detyrave të punës për pozitat e reja dhe përditësimi për pozitat ekzistuese, koordinohet nga Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore në bashkëpunim me njësitë tjera organizative, në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. Auditori i Përgjithshëm i miraton të gjitha përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësitë të punës.

### **Neni 47**

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje nxjerren akte përkatëse.
2. Klasifikimi i pozitave sipas nivelit, paraqitet në Shtojcë të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

### **Neni 48**

#### **Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Auditori i Përgjithshëm, në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

### **Neni 49**

#### **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha aktet të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin e vendeve të punës.


### **Neni 50**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me përjashtim të nënparagrafëve 2.4, 3.4 dhe 4.3 të nenit 25, që hyjnë në fuqi me 01.01.2023.

Prishtinë, 16 shtator 2021

Vlora Spanca



\_\_\_\_\_  
Auditor e Përgjithshme

## SHTOJCË

*Tabela 1: Klasifikimi dhe Gradat*

Emërtimi	Kategoria	Grada
Zëvendës Auditor i Përgjithshëm	KLD	ZKA-A1
Ndihmës Auditor i Përgjithshëm	KLD	ZKA-A2
Drejtor i Përgjithshëm	KLD	ZKA-C1
Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	KMD	ZKA-B1
Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve	KMD	ZKA-B2
Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar	KMD	ZKA-B2
Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza	KMD	ZKA-A3
Drejtor i Departamentit për Metodologji në Auditim	KMD	ZKA-A3
Drejtor i Departamentit për Sigurimin e Cilësisë në Auditim	KMD	ZKA-A3
Drejtor i Departamentit të Auditimit	KMD	ZKA-A3
Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore	KMD	ZKA-C2
Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përbashketa	KMD	ZKA-C2
Drejtor i Departamentit për Teknologji të Informacionit	KMD	ZKA-C2
Udhëheqës i Njesisë së Prokurimit	KMD	ZKA-C3
Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore	KUD	ZKA-C5
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	KUD	ZKA-C5
Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë	KUD	ZKA-C5
Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumentacionit	KUD	ZKA-C5
Udhëheqës i Divizionit për Përkthime	KUD	ZKA-C5
Auditor Specialist	KP	ZKA-A4
Specialist për Teknologji të informacionit	KP	ZKA-A5
Auditor senior	KP	ZKA-A6
Auditor	KP	ZKA-A7
Auditor junior	KP	ZKA-A8
Zyrtar i lartë kundër Mashtrimeve	KP	ZKA-B3
Zyrtar i lartë ligjor	KP	ZKA-B4
Zyrtar për Bashkëpunim	KP	ZKA-B4
Zyrtar për Komunikim dhe Media	KP	ZKA-B5
Zyrtar për Dizajnim të Raporteve dhe Publikime	KP	ZKA-B6
Zyrtar ligjor	KP	ZKA-B6
Zyrtar për administrimin e rrjetit dhe sist. të TI	KP	ZKA-C4
Zyrtar për harduer dhe softuer	KP	ZKA-C4
Zyrtar për përkrahje të sistemeve	KP	ZKA-C4
Zyrtar certifikues	KP	ZKA-C5
Përkthyes	KP	ZKA-C6
Zyrtar për zhvillim profesional	KP	ZKA-C6
Zyrtar për burime njerëzore	KP	ZKA-C7
Zyrtar për buxhet dhe financa	KP	ZKA-C7
Zyrtar për logjistikë	KP	ZKA-C8
Zyrtar për administrim të dokumenteve	KM	ZKA-C8
Vozitës	KM	ZKA-C9
Mirëmbajtës i objektit dhe shërbimeve postare	KM	ZKA-C9

**Shkurtesat:**

- KLD** – Kategori e lartë drejtuese
- KMD** – Kategori e mesme drejtuese
- KUD** – Kategori e ulët drejtuese
- KP** – Kategori profesionale
- KM** – Kategori mbështetëse
- ZKA-A..** – Kategori audituese
- ZKA-B..** – Kategori mbështetëse
- ZKA-C..** – Kategori mbështetëse administrative